

3 tetor 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA **Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit**

Në kuadër të Projektit 'Transparenca Online', EC Ma Ndryshe sot ka publikuar raportin hulumtues mbi Qendrën Historike të Prishtinës, që ka për qëllim vetëdijësimin e komunitetit të gjerë për shkallën e degradimit të saj, nxjerrjen në pah të aktiviteteve të dëmshme në të dhe ngritjen e shqetësimit për të ardhmen e saj. Duke analizuar zhvillimet e fundit në këtë zonë, rëndësinë historike, vlerat e trashëgimisë arkitekturale që ndërthuren brenda kufijve jo të definuar të saj, duke i vënë në pah trajtimet e gabuara të qendrës historike në përgjithësi dhe monumenteve të caktuara në veçanti në dy dekadat e fundit, raporti tenton të ndriçojë realitetin dhe situatën emergjente në të cilën gjendet kjo pjesë e qytetit të Prishtinës, si dhe bën thirrjen e fundit për intervenim dhe mbrojtjen e saj.

Raportit *Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit* është bazuar në shqyrtimin e publikimeve të deritanishme mbi "Qendrën Historike" të Prishtinës, observimin e gjendjes në terren, intervistat me autoritetet nga institucionet përgjegjëse, profesionistë të mbrojtjes së trashëgimisë dhe ekspertë të tjerë, si dhe bën analiza krahasimtare me situata të ngjashme në rajon.

Në bërthamën e Prishtinës, gjendja rezulton të jetë alarmante. Zona Historike e dikurshme u emërua herë Qendër Historike e herë Qytet i Vjetër. Por pavarësisht risive në emërtime, qasja për trajtimin e saj nuk rezultoi të jetë e ndryshme, e aq më tepër e qëlluar. Ky raport sjell në pah të dhëna historike lidhur me bërthamën e qytetit, mënyrën se si u trajtua ajo ligjërisht e në raport me planifikimin urban, si dhe kufijtë e lëvizshëm të saj dhe statusin që ajo gëzon momentalisht. Mes tjerash, disa nga problemet e identifikuar në këtë raport, që kanë sjellë deri te degradimi i "qendrës historike" të Prishtinës radhiten si më poshtë:

- Mungesa e bashkëveprimit insituacional (MKRS-MMPH-KK),
- Mungesa e kufijve të zonës
- Statusi i përkohshëm i mbrojtjes i ndërtesave të trashëgimisë
- Aktiviteti i pandalur ndërtimor brenda zonës
- Mosndëshkimi i dëmtuesve dhe shkatërruesve të ndërtesave të trashëgimisë, etj.

Sado e pashpresë që duket gjendja aktuale në Qendrën Historike, EC Ma Ndryshe beson në një mundësi të fundit për reagim dhe i ofron këto rekomandime:

- Të ndërpriten përkohësisht të gjitha aktiviteteve ndërtimore në "Qendrën historike" të Prishtinës,
- Të zbatohen masat ndëshkuese për veprimtaritë dëmtuese dhe shkatërruese nga ana e organeve përgjegjëse,
- Të kapërcehet hendeku i komunikimit dhe të rritet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e kësaj zone,

- Të merret përsipër përgjegjësia e përbashkët nga ana e institucioneve, veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen, planifikimin dhe menaxhimin e "Qendrës historike" të Prishtinës,
- Të incizohet dhe valorizohet gjendja ekzistuese këtë zonë,
- Të angazhohen ekspertë vendorë dhe të huaj për valorizimin e ndërtesave dhe tërësive në këtë zonë,
- Të futen në mbrojtje të përhershme ndërtesat dhe tërësitë që tash gjenden në listën e mbrojtjes së përkohshme,
- Të përcaktohen kufijt dhe t'i jepet status ligjor i zonës së mbrojtur "Qendrës historike" të Prishtinës,
- Të procedohet me hartimin e planit të konservimit dhe më pastaj me planin e menaxhimit të kësaj zone,
- Të aktivizohet shoqëria civile për ta denoncuar degradimin dhe akterët kryesorë të saj,
- Të zbatohet qasje e integruar në trajtimin e parrregullësive, planifikimin urbanistik dhe mbrojtjen e zonës në përgjithësi, në të mirë të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik në të ardhmen, etj.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit,

ark. Rozafa Basha, koordinatore e projektit
 OJQ EC Ma Ndryshe
 Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren
 Rr. Perandori Dioklecian 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
 +381 38 224 967 & +381 29 222 771
rozafa.basha@ecmandryshe.org



British Embassy
 Pristina

Projekti "Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.